



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 381/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi, Kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga kandidati për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Blerim Grainca nga koalicioni LDK-AKR, paraqitur kundër Vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 01.07.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Blerim Grainca kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni LDK-AKR

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 30.06.2017 në ora 12:05, ka pranuar një ankesë nga Blerim Grainca nga kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni LDK-AKR, në të cilën thekson se në komunën e Vushtrrisë ka mospërputhje të rezultateve të publikuara në formularët e vendvotimeve dhe në rezultatit përfundimtar. Në rezultatet e formularëve edhe pse mungojnë disa vendvotime ai ka 84 vota kurse në rezultatet finale 74 vota. Ndërsa, në bazë të vëzhguesve ka minimum 130 vota dhe se pretendon se në dy variantet është dëmtuar dhe se i njëjti kërkon rinumërim të votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimor, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë dëshmi për ti vërtetuar ato pretendime edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, mirëpo i njëjti me asnjë provë apo dëshmi nuk ka argumentuar se në cilin vendvotim i janë bërë parregullsitë siç pretendon.

Parashtrimet në ankesë nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favore për ankuesin .

Paneli vlerëso se pretendimet në ankesë nuk janë te bazuara dhe nuk i plotëson standardet ligjore si dhe kërkesat e nenit 117 të LZP-së.

PZAP-i, në mungesë të provave dhe dëshmime konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pa argumentuar me fakte dhe si e tillë e pabazuar .

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.381/2017 më datën 01.07.2017.



***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.